



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOS QENDRA PËR SHËRBIM TË QY CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA			
Sh. U.	13	Nr. Br.	2219
Nr. i faq. Br. str.	4	Data Datum:	28/01 2025
KAMENICË/A			

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Mbështetur në nenin:12 paragrafi 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr.04/2017, mbi Financimin Publik të OJQ-ve, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PUBLIKE TË PROJEKTEVE TË OJQ-ve (KLUBET SPORTIVE)

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bën thirrje për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (KLUBET SPORTIVE) të regjistruara dhe të cilat bëjnë gara zyrtare në Federatat përkatëse.
2. Komuna e Kamenicës u bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës (KLUBET SPORTIVE), që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Kamenicës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në avancimin dhe afirmimin e sportit në Komunën e Kamenicës.
3. OJQ-të (KLUBET SPORTIVE) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet në lëmin e sportit dhe sipas fushave mbështetëse si në vijim:
 - Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të referimit për ndeshjet zyrtare.
 - Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të transportit për ndeshje zyrtare.
 - Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të ushqimit për ndeshje zyrtare.
 - Mbështetje financiare për mbulim të shpenzimeve të regjistrimit dhe kodizimit në Federatat përkatëse.
 - Mbështetje Financiare për mbulim të shpenzimeve për blerje të rekuizitave Sportive.
 - Masivizimi i sporteve, promovimi i vullnetarizmit, organizimi i turneve të ndryshme sportive.

Dokumentet kryesore të cilat ofruesi i mbështetjes financiare do të kërkojë të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së (obligative)
2. Certifikatën e numrit fiskal (obligative)
3. Vërtetimin mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore i cili duhet t'i dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare.
4. Të ketë dorëzuar projekt-propozimin e plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (obligative).
5. Të ketë dorëzuar propozim-buxhetin në formatin sipas kërkesës së thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (obligative).
6. Deklaratën e nënshkruar se i njëjti Projekt nuk është pranuar me financim të dyfishtë nga burimet tjera (obligative).
7. Deklaratë se OJQ-ja ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyra financiare vjetore.
8. Një deklaratë me të cilën tregon se i ka përmbushur detyrimet nga mbështetja financiare publike e mëhershme.
9. Të dorëzojë deklaratat e partneritetit në raste kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet .
10. Të dorëzohet CV-ja e menaxherit të projektit.
11. Një deklaratë me të cilën tregon se i ka përmbushur detyrimet nga mbështetja financiare publike e mëhershme (obligative).
12. Kopjet e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së.
13. Vërtetimi/Konfirmimin e llogarisë bankare të OJQ-së (Nuk pranohet kopje e kartelës bankare).
14. Vërtetimin e regjistrimit të klubit/shoqatës.
15. OJQ-të (Klubet Sportive) të cilat kanë raport negativ të evidentuar nga komisioni i monitorimit, nuk do të kualifikohen për mbështetje.

Vlera totale financiare e planifikuar e thirrjes publike është: 45,000.00 euro. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt OJQ-Klub Sportiv është: 550.00 euro, dhe shuma maksimale është 10,000.00 euro.

Organizatave jo-qeveritare (KLUBET SPORTIVE) mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në avancimin dhe fuqizimin e sportit në Komunën e Kamenicës.

4. Afati i aplikimit fillon prej datës **29.01.2025** deri më **18.02.2025**.

5.OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes, periudha e zbatimit të projektit është 9 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të (KLUBET SPORTIVE) që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Kamenicës para datës së publikimit të thirrjes publike, klubet aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit.

KLUBET SPORTIVE duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

6.Para nënshkrimit të kontratës, klubi duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në klub dhe menaxheri i projektit si dhe prova se klubi ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara nëse është e aplikueshme.

7.Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rksgov.net/kamenice>.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E KAMENICËS

Rr."Skënderbeu „

Zyra për shërbim të Qytetarëve

Procesi i pranimit hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve përfshin,

- Vlerësimi i Aplikacioneve,
- Kontraktimi
- Dhënia e Fondeve
- Koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave

Trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: zyrtarit përkatës Shehat Rrudhani, shehat.rrudhani@rks-gov.net, ose në numrin kontaktues 044/311/881.


Drejtore
Behar Hyseni

